

Objekti: "SISTEMIM - ASFALTIM I RRUGËVE HYRËSE DHE DALËSE TË RRUGËS SË ARBRIT, SI DHE REALIZIM I FAZËS 2 TË PUNIMEVE PËR RRUGËN 'CANE - QENDËR GJORICË', NJ. ADM. GJORICË, BASHKIA BULQIZË"

RELACION TEKNIK

MBI PUNIMET GJEODEZIKE DHE TOPOGRAFIKE

Projekt - Zbatimi



Objekti: "SISTEMIM - ASFALTIM I RRUGËVE HYRËSE DHE DALËSE TË RRUGËS SË ARBRIT, SI DHE REALIZIM I FAZËS 2 TË PUNIMEVE PËR RRUGËN 'CANE - QENDËR GJORICË', NJ. ADM. GJORICË, BASHKIA BULQIZË".

Punimet gjeodezike dhe topografike per kete veper te infrastruktures rrugore u kryen mbi bazen e kerkesave teknike te pergjithshme dhe specifike te parashikuara nga Investitori. Firma projektuese: "2 ED" sh.p.k organizoi punen dhe zvilloi punimet ne baze te pervojës se perfituar ne punimet e meparshme te kesaj natyre. Para fillimit te punimeve topografike u siguruan materialet e nevojshme hartografike, gjeodezike si dhe pajisjet perkatese.

Per te siguruar lidhjen gjeodezike unike te te gjithe projektit, nga firma projektuese u shfrytezuan te dhenat gjeodezike te rrjetit shteteror te triangulacionit dhe nivelimit. Sistemi qe perdor Republika e Shqiperise eshte projeksioni Gauss Kryger-it me elipsoid Krasovsky-n.

Rilevimi eshte bere ne sistemin nderkombetar me projeksionin UTM me elipsoid WGS84. Duke patur parasysh zonen dhe ritmin e zhvillimit qe ajo ka, do te ishte me frytshemese nese do te perdorej dhe ky system. Me kete sistem mund te percaktohen lehtesisht koordinatat gjeodezike per cdo pike mbi siperfaqen tokesore nepermjet perdorimit te GPS.

Gjate rikonicionit ne terren u vendosen pikat e triangulacionit dhe markat e nivelimit ne pikat e fiksuara ne terren. Pikat e fiksuara ne terren u pajisen me koordinata ne projeksionin UTM elipsoid WGS84 dhe kuota. Para fillimit te rilevimit u krye pernjohja e detajuar e terrenit, e cila sherbeu per percaktimin e sakte te metodikes se punes, menyren e ndertimit te rrjetit gjeodezik, poligonometrise se rilevimit, nivelimit teknik si dhe organizimit te punes.

Fiksimi ne terren i pikave te rilevimit u krye me shufra hekuri me gjatesi 20 - 30 cm te ngulur toke. Ato jane vendosur ne vende te dukshme dhe te pa levizshme. Identiteti i tyre eshte fiksuar me boje te kuqe te shkruajtur ne afersi te pikes fikse ne vende te dukshme nga rruga ekzistuese. Ato jane vendosur ne vende te qendrueshme, mbi siperfaqen kodrinore ne ane

Objekti: "SISTEMIM - ASFALTIM I RRUGËVE HYRËSE DHE DALËSE TË RRUGËS SË ARBRIT, SI DHE REALIZIM I FAZËS 2 TË PUNIMEVE PËR RRUGËN 'CANË - QENDËR GJORICË', NJ. ADM. GJORICË, BASHKIA BULQIZË"

te rruges qe te kete dhe fushepamje te plote, duke siguruar ne kete menyre lidhjen dhe vazhdimesine e punes nga faza e projektimit ne ate te zbatimit te tij.

Çdo pike e fiksuar ne terren ka numrin, koordinatat e saj, si dhe lartesine e perftuar nepermjet nivelimit gjeometrik e gjeodezik (shih planimetrite topografike te objektit ku gjenden koordinatat tre dimensionale te pikave mbeshtetese). Keto te dhena sigurojne gjetjen e tyre me lehtesi ne terren.

Matjet u kryen me GPS GRX 1 dhe GRX 2, Stacion Total te tipeve te ndryshme si dhe me nivele, te cilet teknikisht siguron matjet e kendeve e largesive me saktesine e nevojshme per projektimin e rrugeve.

GPS GRX 1



Zhvillimi i Nivelimit Gjeometrik:

Per te siguruar kerkesat e larta teknike ne punimet rievuese, u percaktua qe saktesia altimetrike e punimeve topografike te jete e larte dhe per kete qellim u zhvillua nivelim gjeometrik per pikat e poligonometrise ne te gjithë sektoret e rruges.

Nivelimi gjeometrik u krye me nivelen teknike te tipit Kern Level, me metoden e nivelimit teknik te dyfishte, duke matur çdo disnivel dy here, me dy vendosje instrumenti.

Diferenca midis dy disniveleve te perftuar ne çdo stacion nuk u lejua me teper se 3 mm.

Objekti: "SISTEMIM - ASFALTIM I RRUGËVE HYRËSE DHE DALËSE TË RRUGËS SË ARBRIT, SI DHE REALIZIM I FAZËS 2 TË PUNIMEVE PËR RRUGËN 'CANE - QENDËR GJORICË', NJ. ADM. GJORICË, BASHKIA BULQIZË"

Rilevimi:

Duke u mbështetur ne pikat e poligonometrise dhe te nivelimit gjeometrik u zhvillua rrjeti i matjeve topografike te objektit:

"SISTEMIM - ASFALTIM I RRUGËVE HYRËSE DHE DALËSE TË RRUGËS SË ARBRIT, SI DHE REALIZIM I FAZËS 2 TË PUNIMEVE PËR RRUGËN 'CANE - QENDËR GJORICË', NJ. ADM. GJORICË, BASHKIA BULQIZË".

Objektet qe u pane ne terren jane hedhur ne relief te gjithë. Punimet topogjeodezike te kryera jane mbështetur ne shkallen e plote te pergatitjes profesionale, ne perdorimin e teknologjive bashkekohore per matjet fushore dhe perpunimin kompjuterik te te dhenave, per te plotesuar kerkesat teknike te parashtruara nga projektuesit. Çdo pike e marre ne terren ka koordinata tre dimensionale, te paraqitura ne projekt.

Perpunimi i materialit topografik ne zyre eshte bere me programin STRATO dhe LEONARDO, TGO, AutoCAD Land Development dhe AutoCAD Civil 3D max nga ku eshte perftuar rilevimi ne fshatrat e Gjorices, Bulqize. Ky relief sherbeu per hartimin e projektit te zbatimit me saktesine dhe cilesine e kerkuar ne termat e references nga investitori.

Ne materialin grafik te projektit jepet planimetria e fiksimeve dhe tabela e koordinatave te pikave te vendosura ne terren.

Pershkrimi i Punes ne Terren:

Per mbështetjen e punimeve fillimisht u krijuan 4 pika te forta te cilat jane te mjaftueshme per kryerjen e pikave detaje te rilevimit. Matja e ketyre pikave u kryen me metoden statike duke qendruar ne pike rreth 40 min ne intervalin 1 sek duke siguruar saktesi milimetrike te koordinatave te pikave.

Prania e marresit baze ne largesi te kufizuar siguron saktesi me te larte te matjeve ne interval kohe me te shkurter. Keshtu, per pikat deri ne 1 km distance nga marresi baze u perdor intervali 10 sek me matje per çdo sekonde ndersa per largesi me te madhe deri ne 2 km intervali 15 sek. Elementi kryesor ne matjen 'stop & go' eshte mos humbja e lidhjes se fazes bartese gje e cila prish zgjidhjen perfundimtare. Kjo mund te realizohet duke shmangur futjen ne zona hije te sinjalit ose zona me reflektim te madh sinjali. Ne kete rast marresit GPS GRX 1 japin nje sinjal i cili lajmeron matesin se duhet te rifilloje matjen nga nje pike e matur paraprakisht, duke siguruar saktesine e kerkuar. Ne zonat me dendesi pemesh u perdor Stacioni Total pasi kishte dege te larta te cilat nuk lejojne matjen e pikave detaje me GPS.

Objekti: "SISTEMIM - ASFALTIM I RRUGËVE HYRËSE DHE DALËSE TË RRUGËS SË ARBRIT, SI DHE REALIZIM I FAZËS 2 TË PUNIMEVE PËR RRUGËN 'CANE - QENDËR GJORICË', NJ. ADM. GJORICË, BASHKIA BULQIZË"



PËRGATITI:

"2 ED" sh.p.k

Drejtues Teknik:

Ing. Top. BILBIL NURÇE

